



REPUBLIKA ESHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 640 Prot.

Gjirokastrë, më 16/05/2023

V E N D I M

Nr 21 , datë 16.05.2023

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS, SË RISHIKUAR NË UGJ

Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtat e informimit"; të urdhërit nr. 187 datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar", të ndryshuar me urdhër nr. 35, datë 31.03.2021; nenet 6 pika 1/c dhe 23 pika 2/b të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës, 16.05.2023,

V E N D O S I ;

1. Të miratojë programin e rishikuar të transparencës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në kuadër të detyrimeve që vijnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen zëvendës rektorët dhe koordinatori për të drejtën e informimit;
3. Këtij vendimi i bashkëlidhet Programi i Transparencës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA